

# 2023 RAPORTI VJETOR



# TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e Përmbajtjes	2
Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv	3
Letër nga Kryetari i Bordit	4
Reflektim mbi vitin 2023	5
Kohorta e Katërt	6
Harta e Mbulueshmerisë	8
Instituti Veror 2023	9
Shkolla Verore 2023	10
Sesionet mujore të trajnimit	11
Projektet	12
Teach For Kosova Alumni	18
Partnerët strategjikë	19
Stafi i Teach For Kosova	23

# MESAZHI NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Të dashur miq dhe mbështetës të Teach For Kosova,

Ndërsa shënojmë **vitin e pestë të punës së Teach For Kosova**, ky është një moment reflektimi, mirënjohjeje, dhe angazhimi të vazhdueshëm. Këtë vit, ne e gjejmë veten thellësisht mirënjohës për mbështetjen tuaj të palëkundur ndër vite. Përkushtimi juaj ka luajtur një rol kyç për të mundur arritjen e 5-vjetorit, dhe së bashku, ne kemi shtruar themelin për ndryshime pozitive **dhe të duhura në sistemin arsimor të Kosovës**.

Gjatë këtyre viteve, Teach For Kosova ka përparuar në shumë aspekte dhe është inkurajuese të shohësh ndikimin që Fellows tanë kanë pasur në jetën e nxënësve në mbarë Kosovën. **Ne kemi rekrutuar gjithsej 72 kandidatë gjatë katër kohortave të fundit dhe entuziazmi nga aplikantët mbetet i lartë**, me një numër të qëndrueshëm aplikimesh nga viti në vit.

Bashkëpunimi ynë me mbi gjysmën e komunave të Kosovës për vendosjen e mësimdhënësve dhe zbatimin e projekteve, dëshmon që Teach For Kosova është organizatë kyçe në komunitetin e arsimit të Kosovës. **Projektet si “Let Girls Thrive” dhe “Future of Education” kanë mundur ndikimin e drejtpërdrejtë në sistem duke zhvilluar kurrikulë arsimore me kontekst të ndjeshëm gjinor, si dhe duke mbështetur komunitat e Kosovës për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve**. Si organizatë, ne po bëhemi zë që avokon për ndryshime pozitive dhe inovacione në sistemin e arsimit të Kosovës.

Gjersa festojmë arritjet tona, në vazhdimësi kuptojmë nevojat për përmirësim në sistemin e arsimit. Forcimi i marrëdhënieve tona me Ministrinë e Arsimit mbetet një synim madhor për Teach For Kosova. Përtej partneriteteve institucionale, komuniteti ynë i Alumni vazhdon të rritet dhe Teach For Kosova mbështet zhvillimin e iniciativave brenda dhe jashtë shkollave për të kontribuar në ndikimin **e vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit**.

Më shumë se kurrë, jam i entuziazmuar për të ardhmen e Teach For Kosova. Në vitin 2024, do të thellojmë ndikimin tonë dhe të krijojmë partneritete të reja. Angazhimi ynë për **ndikimin kolektiv nënvizohet nga rëndësia e rritjes së bashkëpunimit me OJQ-të lokale të arsimit**, pasi ne besojmë se së bashku, mund të realizojmë vizionin tonë për një sistem arsimor të barabartë, cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit 2024, ne presim me padurim mundësitë për të mësuar dhe kontribuar më tutje në edukim në Kosovë. **Mbështetja juaj e vazhdueshme është jetike për neve**, dhe jemi mirënjohës që ju kemi pranë gjatë misionit tonë të përbashkët.

Me mirënjohje dhe entuziazëm,

Egzon Gashi



# LETËR NGA KRYETARI I BORDIT

Viti 2023 ishte vit i zhvillimit për Teach For Kosova. Kjo është një dëshmi e përkushtimit dhe ndjeshmërisë së partnerëve tanë, qeverisë së Kosovës dhe stafit tonë.

## Pyetja është, si të veprojmë tutje?

Bordi i TFK-së e ka kaluar pjesën më të madhe të këtij viti duke hartuar planin tonë strategjik për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Dhe përgjigja është kjo: **është koha për të zgjeruar shërbimin tonë për të gjitha komunitetet dhe për të ofruar trajnime për mësimdhënës ekzistues si dhe menaxhmentin e shkollave.** Kjo nuk do të thotë se angazhimi ndaj Fellows tanë është lëkundur ose ndryshuar. Rezultatet aktuale në arsim në Kosovë na kanë detyruar të përshtatemi shpejt për të siguruar që kemi resurse mbështetëse për misionin tonë në mënyrë që të gjithë nxënësit e Kosovës të marrin edukimin më të mirë të mundshëm.

Edukimi i mirëfilltë i fëmijëve tanë është edhe mënyra se si **i nderojmë ata që sigurojnë pavarësinë e Kosovës.** Kjo është mënyra se si ne i përgatisim, fuqizojmë dhe frymëzojmë ata që janë më të cenueshëm sot, por që do të na zëvendësojnë përfundimisht si udhëheqës të institucioneve dhe shtetit tonë.

**Angazhimi ynë për barazi kërkon që ne t'u shërbejmë të gjithë fëmijëve sipas nevojave të tyre.** Falë këtij ndryshimi në mendësi, ne tani po synojmë resurse shtesë për ato komunitete dhe po zgjerojmë shtrirjen tonë. Se fundmi, ne e dimë se ky vizion është i arritshëm - nëse punojmë së bashku.

## A JENI ME NE?



Kryetar i Bordit




*Edukimi i mirëfilltë i fëmijëve tanë është edhe mënyra se si i nderojmë ata që sigurojnë pavarësinë e Kosovës. Kjo është mënyra se si ne i përgatisim, fuqizojmë dhe frymëzojmë ata që janë më të cenueshëm sot, por që do të na zëvendësojnë përfundimisht si udhëheqës të institucioneve dhe shtetit tonë.*

Dr. Gjergj Haxhiu




Anëtare e Bordit

Dr. Lori Sanchez



Anëtar i Bordit

Armend Berisha



Anëtar i Bordit

Sovran Berisha

# REFLEKTIM PËR VITIN E KALUAR

“Në vitin 2023 Teach For Kosova vazhdoi me programin e saj të Fellowship-it me **15 Fellows të rinj**, si dhe organizoi një diskutim rreth pjesëmarrjes së udhëheqësve të arsimit nga Diaspora në procesin e zhvillimit të arsimit në Kosovë.”




## Ngjarjet kryesore nga 2023:

- Rekrutuam Kohortën tonë të katërt të Fellowsëve  
**86.67% vajza** si dhe **13.33% nga komunitetet pakicë**;
- Në bashkëpunim me MPJD-në organizuam diskutimin me temën “*Si mundet Diaspora të mbështesë zhvillimin e arsimit në Kosovë?*”
- Përfunduam me sukses projektin “Promovimi i Mendimit Kritik dhe Kohezionit Multietnik në mesin e të rinjve” që u mbështet nga National Endowment for Democracy.
- Diplomoi Kohorta e Dytë e Teach For Kosova. **16 Fellows** që diplomuan, u bënë pjesë e Lëvizjes Alumni të TFK-së.
- Mbajtëm **Shkollën Verore 2023** në partneritet me Komunën e Prishtinës, për të tretin vit me radhë.
- Zhvilluam projekte së bashku me US Embassy, Teach For All, Danish Refugee Council (DRC), për lehtësimin e mësimit pas shkollës dhe mësimin plotësues për nxënës.


# KOHORTA E KATËRT

Në vitin 2023, **Teach For Kosova** rekrutoi, trajnoi dhe vendosi Kohortën e Katërt prej **15 liderësh të rinj të jashtëzakonshëm**. Ne vazhdojmë të rekrutojmë dhe zgjerojmë forcën tonë të udhëheqjes kolektive, e cila do të punojë për të krijuar ndryshime sistematike.


## Etnia



## Fusha e Studimit



## Statistikat e Rekrutimit



- 180 Aplikime të pranuar
- 58 të ftuar në Qendrën e Vlerësimit
- 15 Fellows të pranuar

8.33% e aplikantëve janë **pranuar**.

# KOHORTA E KATËRT



**Komuna:** Prizren, Kosovë  
**Bachelor:** Edukim Fillor

Ardora HASKUKA



**Komuna:** Ferizaj Kosovë  
**Bachelor:** Master i  
mësimdhënies me  
specializim në Fizikë

Blerta UKSHINI

“ Vera e kaluar në një institut veror u bë një kapitull frymëzues në rrugën time të zhvillimit personal dhe profesional.

Teach for Kosova më ofroi mundësinë e njohjes me profesionistë të fushave të ndryshme, ku përmes seminareve inovative, diskutimeve të thella dhe bashkëpunimit, arrita të krijoj një rrjet të pasur me njerëz me të cilët ndaj të njëjtat pasione dhe synime.

*Përshkruar me një fjalë të vetme institutin: frymëzues. Frymëzim për të mësuar, për të ndryshuar dhe për të punuar drejt një qëllimi.*

Ndërsa kthehem në përditshmëri, mbaj me vete një bagazh të pasur me njohuri dhe një motivim për të shpërndarë përvojat që po ndikojnë në mësimdhënien dhe lidhshimin tim. Me këtë bagazh njohurish jam gati të vazhdoj të kontribuoj në fushën e arsimit dhe të ndaj përvojën me komunitetin tim.

Mirënjohëse do të jem përherë për këtë oazë të sigurt, ambient të ngrohtë që ka ndikuar në ushqimin e pasioneve dhe shpirtit tim, përgjatë rrugës së rritjes personale. E lumtur që së bashku po ndërtojmë një histori të përbashkët të arritjeve dhe suksesit.

“ Insituti veror i Teach for Kosova, më dha mundësinë të zhytem në artin e mësimdhënies.

Duke përqafuar bukurinë e diversitetit në grup, ku kulturat, prejardhja dhe perspektivat ndryshonin nga njëra te tjetra, unë pata mundësi të thellohem në botën e edukimit dhe të fitoja njohuri e shkathtësi të cilat më japin siguri në secilin hap si mësimdhënëse.

*Angazhimi dhe kontributi maksimal i i ekipit të Teach For Kosova në secilin detaj, të secilës ditë për 5 javë, ka qenë inspirim për mua jo vetëm si mësimdhënëse por edhe si person.*

Jam e bindur se përvojat dhe kujtimet e periudhës përgjatë së cilës jam pjesë e Teach For Kosova, do të formojnë përgjithmonë rrugëtimin tim profesional, gjë për të cilën do të jem mirënjohëse përherë.



# HARTA E MBULUESHMËRISË



## Teach For Kosova

Ka krijuar partneritete bashkëpunimi me 16 komuna në mbarë vendin, duke nënvizuar përkushtimin e saj për avancimin e arsimit në Kosovë. Në këtë kuadër, Fellows tanë luajnë një rol të rëndësishëm, duke marrë pjesë aktive në nisma dhe projekte arsimore brenda 27 shkollave publike të shpërndara në të gjithë vendin.



# INSTITUTI VEROR 2023

## NJË VËSHTRIM NGA AFËR



- Trajnuam 15 Fellows për pesë javë me radhë.
- Temat variuan nga njohja më e thellë e pabarazive në sistemin e arsimit të Kosovës, në luftimin dhe avokimin për ato pabarazi, përmes zhvillimit të Fellows si mësimdhënës liderë.
- Në sondazhin tonë pas institutit, 100% e Fellows u përgjigjën me 10/10 kur u pyetën nëse do t'i rekomandonin programin e Fellowship-it një miku/mikeie



- Për vitin e katërt me radhë, të ftuar ishin ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të arsimit dhe lidershipit, folës inspirues dhe liderë të njohur në Kosovë.



# SHKOLLA VERORE 2023. NJË VËSHTRIM NGA AFËR

- Si pjesë e Institutit Veror 2023, Teach For Kosova organizoi edicionin e tretë të Shkollës Verore.
- Shkolla Verore është krijuar për të ofruar një program veror falas, argëtues dhe informues për nxënësit në Kosovë.
- Fellows përveç trajnimeve, praktikuan mësimdhënien gjatë 3 javëve të shkollës verore.



Datat e shkollës verore: 10 - 28 korrik 2023

- Shkolla Verore ka përfshirë gjithsej 130 fëmijë, nga të cilët 50 ishin nga minoritetet etnike në Kosovë. Kjo ka promovuar gjithëpërfshirjen dhe diversitetin, si dhe ndihmën ndaj këtyre komuniteteve drejt arsimimit dhe zhvillimit;
- Nxënësit kishin 15 ditë mësimi, duke përfshirë tri ditë aktivitete të cilat mbaheshin tërësisht në natyrë;
- Lëndët e mbajtura gjatë Shkollës Verore varionin nga “Të menduarit kritik përmes librave dhe filmave”, “Psikologjia e rregullimit të Emocioneve”, “Fizika përmes eksperimenteve”, “Edukimi Medial” etj.



# SESIONET MUJORE TË TRAJNIMIT NJË VËSHTRIM MË I AFËRT

Gjatë vitit 2023, ekipi i programit të Teach For Kosova në vazhdimësi ka organizuar trajnime tematike mujore, me qëllim të zhvillimit dhe mbështetjes së **Fellows tanë, në të qenit mësimdhënës lider në komunitetet e tyre.**



## Viti i parë i Fellowshipit

Tematikat, si: "Mësimi i orientuar në vizion", "Familjet dhe klasa: Ndërtimi i raporteve efektive për zhvillimin socio-emocional të nxënësve", "Vlerësimi i nxënësve dhe hartimi i testeve përmbledhëse sipas taksonomisë së Bloom-it" janë disa nga temat e përfshira përgjatë trajnimeve mujore me Fellows të kohortës së 4-të.

Ata kanë krijuar vizionin e tyre bashkë me nxënësit dhe së bashku me ta po punojnë çdo ditë në përforsimin dhe përmirësimin e praktikave mësimore, në kultivimin e ndjenjës së përkatësisë dhe në zhvillimin e aftësive të udhëheqjes në klasa e më tej.

## Viti i dytë i Fellowshipit

Me Fellows të Kohortës së 3-të, ekipi i programit ka zhvilluar trajnime tematike mujore për t'i mbështetur ata në përforsimin tutje të aftësive të lidërshiptit dhe avokimit për arsim e shoqëri, në komunitetet ku ata veprojnë.

Trajnimet, si: "Teoria e ndryshimit dhe teoria e lidërshiptit", "Mësimdhënia si lidërshipt kolektiv", "Shkrimi i projekteve", "Qasja në Drejtoritë Komunale për Arsim", janë vetëm disa nga tematikat që kanë kontribuar në përpjekjet e Teach For Kosova për të adresuar pabarazitë, për të përgatitur liderë të së ardhmes, të cilët avokojnë për arsim cilësor dhe ndikim pozitiv në zhvillim të shoqërisë.

*Në vijim të këtij rrugëtimi, do të vazhdojmë të punojmë me pasion dhe përkushtim për të siguruar një arsim cilësor për të gjithë nxënësit në Kosovë dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë.*

# PROJEKTI FUTURE OF EDUCATION

Viti 2023 ishte viti i dytë i projektit “Future of Education”. Përmes kësaj nisme, të mbështetur nga Teach For All, Teach For Kosova ka pasur një synim: të **bashkëkrijojë dhe të pilotojë një sistem të ri të vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve** për të gjithë mësimitdhënësit në Republikën e Kosovës – një sistem që është gjithëpërfshirës, i drejtë dhe që jep rezultate të zbatueshme.

Meqë Vlerësimi i Performancës së Mësimitdhënësve (VPM) është një temë e ndjeshme në Kosovë, **Teach For Kosova e sheh këtë projekt si një nga përpjekjet tona më ambicioze për të pasur ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin e arsimit.** Gjatë vitit të parë të projektit, kemi punuar me komunat e Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës, Ferizajt dhe Podujevës për të zhvilluar instrumentet për vlerësimin e mësimitdhënësve.

Pas zhvillimit të instrumenteve, Teach For Kosova pilotoi metodën e re të vlerësimit me 10 Fellows.

Gjatë muajve të fundit të vitit 2023, u **zgjodhën 25 shkolla dhe 500 mësimitdhënës të cilët tani do të jenë pjesë e pilotimit** më të gjerë. Gjithashtu, u nënshkruan memorandume mirëkuptimi me secilën komunë për vitin e dytë të projektit.

Në vitin 2024, Teach For Kosova po pret me padurim zbatimin dhe **rezultatet e vlerësimit me 500 mësimitdhënës.** Deri në fund të projektit, shpresojmë të fitojmë njohuri të vlefshme për instrumentet e krijuara dhe përfundimisht ta adaptojmë këtë projekt me sistemin kombëtar të vlerësimit të performancës së Kosovës.



# PROMOVIMI I MENDIMIT KRITIK DHE KOHEZIONIT MULTIETNIK NË MESIN E TË RINJVE

Në fund të viti 2023, Teach For Kosova me përkrahje të National Endowment For Democracy, ka përmbyllur me sukses projektin “Promovimi i Mendimit Kritik dhe Kohezionit Multietnik në mesin e të rinjve”, që u realizua në 5 komunat e Kosovës: Skenderaj, Lipjan, Podujevë, Shtime dhe Gjakovë.

Në këto komuna, 10 shkolla të mesme profesionale dhe gjimnaze, 5 Fellows të Kohortës së Tretë u angazhuan plotësisht në trajnimin e 200 nxënësve për të zhvilluar mendim kritik dhe aktivizmin qytetarë.

Nxënësit e këtyre shkollave nëpërmjet debatit dhe diskutimeve të hapura demonstuan pasionin e tyre për të sjellë ndryshime pozitive në komunitetin ku jetojnë.

Temat që u trajtuan ishin të ndryshme dhe të rëndësishme për zhvillimin e tyre si individë dhe për shoqërinë: nga lufta kundër bullizmit dhe paragjykitimeve, deri te njohja e vetes dhe barazia gjinore. Nxënësit treguan guxim dhe zgjuarsri në trajtimin e çështjeve të ndjeshme si migrimi i të rinjve dhe ngacmimet seksuale.

Një moment i veçantë ishte organizimi i 'Living Librariës' nga nxënësit e Klubve të Debatit në secilën komunë, ku ata patën rastin të diskutonin me 'Librat e Gjallë' për motivimin, suksesin, dhe sfidat që përballonin në rrugën e tyre drejt një të ardhmeje të ndritshme.

Në aktivitetin e fundit të projektit, nxënësit u takuan me kryetarët e komunave në dëgjime publike. Ata diskutuan me kryetarët e tyre në një mjedis jo-formal dhe prezantuan kërkesat e tyre për të përmirësuar komunitetin ku jetojnë.



# PËRMIËSIMI I QASJES DHE MUNDËSIVE PËR FËMIJËT E KOSOVËS

Teach For Kosova në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së në Kosovë është duke realizuar projektin “Përmirësimi i qasjes dhe mundësive për fëmijët e Kosovës”, që synon të adresojë pabarazitë në arsim dhe për të krijuar mjedise gjithëpërfshirëse të mësimi.

Në kuadër të projektit Teach For Kosova ka identifikuar shkollat që kanë nevojë për ndihmë. Përmes takimeve me Drejtorët Komunal të Arsimit, u arritën marrëveshje për të identifikuar shkollat që do të ishin përfituese të këtij projekti.

Shkollat e zgjedhura, duke përfshirë Shkollën Filllore "Fazli Greiçevci" në Mitrovicë, Gjimnazin "Ulpiana," në Gadime të Lipjanit, Shkollën Filllore "Naim Frashëri" në Zaskok, Ferizaj dhe Gjimnazi "Hivzi Sylejmani" në Fushë-Kosovë, u pajisën me materiale të nevojshme si **laptopë, projektorë, printerë, libra në gjuhën angleze, kënde të leximit, kokërrshilte, dhe materiale didaktike, duke i transformuar ato në hapësira inkluzive.**

Gjithashtu projektua dhe implementua mësim shtesë të përshtatura për nevojat e nxënësve nga grupet e marginalizuara.

Përmes mbështetjes së Fellows të Teach For Kosova dhe ekipit të programit, u zhvilluan kurrikula me përmbajtje atraktive që përfshinin lëndë të ndryshme si **Sporti Inkulziv, Inxhinieria e Ushqimit, Gjuha Angleze, dhe Edukimi Medial.**

Këto lëndë jo vetëm ofruan pasurim akademik, por edhe **promovuan diversitetin, barazinë gjinore dhe kohezionin shoqëror, për mbi 160 nxënës në këto 4 komuna.**

Me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, duke përfshirë një shpërndarje të balancuar gjinore dhe përfaqësim multi-etnik, **impakti i këtyre iniciativave është i thellë.**



# DISKUTIM: SI MUNDËT DIASPORA TË MBËSHITESË ZHVILLIMIN E ARSIMIT NË KOSOVË?

Në kuadër të programit "Instituti Veror 2023" të organizatës Teach For Kosova, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, u zhvillua një diskutim rreth pjesëmarrjes së udhëheqësve të arsimit nga Diaspora në procesin e zhvillimit të arsimit në Kosovë.

Diskutimi u mbajt me qëllim të identifikimit të mënyrave për të rritur përfshirjen e diasporës në sektorin e arsimit të Kosovës.

Në këtë takim, përfaqësuesit e diasporës prezantuan disa sugjerime dhe qëndrime rreth mënyrave se si ata mund të kontribuojnë më aktivisht në avancimin e arsimit në Kosovë. Në veçanti, u theksua nevoja për investime të mëtijshme në fushën e leximit dhe krijimin e një dege të veçantë të analizës së sjelljes në kontekstin e arsimit.

Egzon Gashi, Drejtor Ekzekutiv i Teach for Kosova, theksoi synimin e tyre për të sjellë kontributin e diasporës në pjesën më të ndjeshme të shoqërisë së Kosovës, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së tyre në fushën e arsimit.

Në diskutim morën pjesë edhe disa përfaqësues të arsimit nga diaspora, si Suzana Aliu, mësimdhënëse e gjuhës suedeze dhe angleze në një shkollë në kryeqytetin e Suedisë, e cila theksoi rëndësinë e leximit dhe kuptimit të tekstit.

Gjithashtu, Tringë Krasniqi-Gashi, mësimdhënëse e fëmijëve me autizëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe profesori i edukimit special, Gjergj Haxhiu, nga SHBA-të, shpalosën nevojën për përdorimin e analizës së sjelljes në çdo shkollë fillore dhe të mesme, si një mjet për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në përfundim, është vlerësuar se përfshirja e diasporës në zhvillimin e arsimit në Kosovë paraqet një mundësi të rëndësishme për avancimin dhe përmirësimin e sistemit arsimor në vend. Strategjitë dhe sugjerimet e prezantuara në këtë diskutim do të shërbejnë si udhërrëfyes për hapat e ardhshëm për përfshirjen dhe kontributin e diasporës në këtë drejtim.



# FUQIZIMI I MËSIMDHËNËSVE TË RINJ NGA KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJPTIAN

Në tetë shkolla publike u realizuan punëtori që kishin për qëllim të nxirrnin përvojat më të mira të mësimit për të gjithë nxënësit në edukim.

Fellows nga Kohorta e Katërt e Teach For Kosova, bashkë me mësimitdhënësit, punuan së bashku për të krijuar aktivitete për katalogun e arsimit gjithëpërfshirës. **Këto aktivitete do të përfshihen në katalogun për edukimin inkluziv**, duke sjellë një koleksion teknikash dhe metodash të përditësuara për mësimitdhënien dhe punën me fëmijë.

Nga **10 mësimitdhënës prej secilës shkollë u zhvilluan nga 10 aktivitete**. Këto aktivitete do të jenë pjesë e katalogut për edukimin inkluziv i cili do të publikohet dhe shpërndahet në të gjitha shkollat e Kosovës në vitin 2025, **që do të përmbajë mbi 200 aktivitete për edukimin inkluziv**.

Këto punëtori u zhvilluan në tetë komunat partnere: **Podujevë, Prizren, Deçan, Suharekë, Kaçanik, Ferizaj, Mitrovicë dhe Vushtri**.

Falënderojmë **mësimitdhënësit për një bashkëpunim shumë të frytshëm** dhe mbresëlënëses në këto punëtori. Shkolla fillore Destan Bajraktari, SHFMU "Mati Logoreci", SHFMU "Shefki Kuleta" Tërrnavë, SHFMU "Naim Frashëri, SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan, Shkolla "Anton Z. Cajupi", Shkolla "Fazli Greiçevci" Shipol dhe SHFMU Kadri Zeka, Dubravë, Kaçanik.

Gjithashtu, përmes këtij projekti, **50 nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**, kanë qenë pjesëmarrës në #ShkollaVerore2023. Këta nxënës u angazhuan në një gamë të gjerë aktiviteteve të dizajnuara për të nxitur edukimin, socializimin dhe argëtimin.





# LET GIRLS THRIVE

Me përkrahje nga Teach For All, në vitin 2023 kemi filluar **implementimin e projektit disa vjecar "Let Girls Thrive"** që ka qëllim të adresojë disa nga sfidat kryesore të kohezionit social me të cilat ballafaqohen vajzat nga grupet e marginalizuara në Kosovë.

Projektin **"Let Girls Thrive"** kemi duke e realizuar në **partneritet me OJQ-në QIKA**, ku kemi hartuar një modul trajnimi gjithëpërfshirës gjatë **Institutit Veror 2023**, ku trajnuam Fellows të Kohortës së Katërt, duke i njohur ata me rëndësinë e përfshirjes së perspektivës gjinore në mësimdhënie.

Përgjatë këtij trajnimi ata morën njohuri të hollësishme për konceptet bazë të barazisë gjinore dhe pabarazitë ekzistuese në Kosovë, **me theks të veçantë në sektorin e arsimit**. Kjo përvojë ndihmon Fellows që si mësimdhënës të angazhohen dhe të shtyjnë përpara barazinë gjinore dhe sociale.

Nga muaji shtator kemi filluar edhe ciklin e trajnimeve mujore me **5 Fellows të Kohortës së Katërt të angazhuar në këtë projekt**. Fellows përgjatë projektit do të japin mësim në shkollat publike të Kosovës, e ku gjatë trajnimeve mujore do t'ju ofrojmë atyre informatat e mjetet e nevojshme që të përfshijnë perspektivën e barazisë gjinore në mësimdhënje.

Gjithashtu kemi **formuar klube të vajzave dhe djemëve në 5 komunat partnere në këtë projekt**: Suharekë, Lipjan, Vushtrri, Prizren dhe Ferizaj. **Fellows po ju ofrojnë njohuri mbi 75 nxënësve** në shkollat e përzgjedhura, për ceshtjet si: dhuna në baza gjinore, orientimi në karrierë, e drejta në pronë, diskriminimet në bazë të gjinisë e shume tematika tjera.

Ky është viti i parë i këtij projekti i cili do të zgjasë tri vite dhe ka synim kryesorë, **përpilimin e lëndës zgjedhore, e cila do t'i prezantohet Ministrisë së Arsimit, që të futet si lëndë zgjedhore në shkollat e Kosovës**.

Së bashku, **Teach For Kosova, QIKA dhe Fellows e përkushtuar** po nxisin ndryshime të prekshme, po sfidojnë normat dhe po hedhin bazat për një të ardhme më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.



# TEACH FOR KOSOVA ALUMNI

Identifikojnë në mënyrë aktive sfidat arsimore, forcojnë ndërgjegjësimin në vetvete dhe te të tjerët dhe në bashkëpunim të miratojnë zgjidhje. Këta të diplomuar nuk janë vetëm edukatorë; ata janë aktivistë të cilët pa u lodhur avokojnë për një sistem arsimor të barabartë dhe gjithëpërfshirës në Kosovë.



## Alumni janë të fokusuar në 3 fusha:

- Udhëheqja e shkollës;
- Politika publike (niveli komunal dhe ministror);
- Ndërmarrjet Sociale.

## Lëvizja Alumni

Në vitin 2023, Lëvizjes Alumni të TKF-së i janë bashkuar edhe **16 Fellows të Kohortës së Dytë**, të cilët në qershor kanë përfunduar me sukses Fellowship-in dyvjeçar të Teach For Kosova.

Teach For Kosova ka 29 Alumni aktivë si pjesë e Lëvizjes.

## Rrjeti Global

Teach For Kosova, bashkë me 62 shtete të tjera në të gjithë botën, është pjesë e rrjetit global të Teach For All, të cilët po ndryshojnë thellësisht fushën e arsimit.

Valmira Morina, **Fellow e Kohortës së Parë dhe Alumna i Teach For Kosova**, ka pasur mundësinë të marrë pjesë në Fellowshipin 1 vjeçar të **Teach For All** për Leadership në Edukim, duke u bërë pjesë e gjeneratës së parë të **European Alumni Leadership Fellowship**.



# PARTNERËT STRATEGJIKË



## Teach For All

Përmes fondit “Future of Education” të mbështetur nga Teach For All, TFK synon të krijojë një kornizë të re për vlerësimin e mësimdhënësve. Gjithashu përmes projektit “Let Girls Thrive” Teach For Kosova synon të mbështesë dhe të fuqizojë disa nga gjeneratat e ardhshme të grave udhëheqëse në Kosovë.

# 01



Në vitin 2023, Teach For Kosova ka filluar të zbatojë projektin 3 vjeçar “Fuqizimi i mësimdhënësve të rinj nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian” i cili është mbështetur nga Këshilli Danez për Refugjatë përmes fondeve të Agjencionit Suedez për Bashkëpunim në Zhvillim Ndërkombëtar – Sida.

# 02



# PARTNERËT STRATEGJIKË



Teach For Kosova me mbështetjen e NED, ka realizuar projektin “Promovimi i Mendimit Kritik dhe Kohezionit Multietnik në mesin e të rinjve” ku formuam klube të debatit, duke bërë të mundur zhvillimin e shkathtësive të shekullit XXI të nxënësit, dhe qasje të liderët e komunave të tyre për të diskutuar se si të zhvillojnë komunën.

# 03



Teach For Kosova në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së në Kosovë është duke realizuar projektin “Përmirësimi i qasjes dhe mundësive për fëmijët e Kosovës”, që synon të adresojë pabarazitë në arsim dhe për të krijuar klase inkluzive të mësimi.

# 04



# PARTNERË STRATEGJIKË DHE SPONZORË



Republika e Kosovës

**MINISTRIA E PUNËVE  
TË JASHTME DHE DIASPORËS**

Me përkrahjen e MPJD-së, Teach For Kosova ka realizuar me sukses Shkollën Verore, ku pjesëmarrës ishin edhe fëmijë nga Diaspora. Gjithashtu për herë të parë kemi rekrutuar një Fellow nga Diaspora, si dhe në kuadër të Insitutit Veror 2023, është organizuar një diskutim me profesorë dhe njohës të edukimit nga Diaspora.

## 05



PRISHTINA

Për vitin e tretë radhazi, jemi partnerë me Komunën e Prishtinës në organizimin e Shkollës Verore. Këtë vit mbi 80 nxënës nga shkollat e kryeqytetit ishin pjesëmarrës në Shkollën Verore 2023.

## 06



Tashmë është bërë traditë bashkëpunimi i Teach For Kosova me kompaninë Tepelene. Në Shkollën Verore 2023, nxënësit patën mundësi të freskohen me Ujë Tepelene.

## 07

# PARTNERËT STRATEGJIKË



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT



## PARTNERITETET ME SEKTORIN PUBLIK

Komuna e Prishtinës  
Komuna e Fushë Kosovës  
Komuna e Ferizajt  
Komuna e Prizrenit  
Komuna e Gjakovës  
Komuna e Skenderajt  
Komuna e Suharekës  
Komuna e Rahovecit

Komuna e Podujevës  
Komuna e Lipjanit  
Komuna e Decanit  
Komuna e Shtimes  
Komuna e Malishevës  
Komuna e Drenasit  
Komuna e Pejës  
Komuna e Mitrovicës

## PARTNERITETET ME ORGANIZATA

OJQ QIKA  
Germin  
Roma Versitas Kosovo

Voice of Roma, Ashkali & Egyptians  
OJQ Durmish Aslano  
The Ideas Partnership

## PARTNERITETET ME UNIVERSITETE

Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"  
Universiteti i Shkencave të Aplikuara  
në Ferizaj  
Universiteti i Prizrenit  
"Ukshin Hoti"

Universiteti i Pejës  
"Haxhi Zeka"  
Universiteti i Gjakovës  
"Fehmi Agani"  
Universiteti i Mitrovicës  
"Isa Boletini"

# STAFI I TEACH FOR KOSOVA



Drejtor Ekzekutiv

**Egzon Gashi**



Drejtoreshë për Zhvillim

**Anita Plakolli**



Menaxher i Financave

**Visar Kurti**



Menaxhereshë e Programit

**Albina Avdyli**



Menaxher i Zyrës

**Kastriot Muçolli**



Menaxhereshë e Projekteve

**Valmira Morina**



Menaxhereshë e Rekrutimit

**Erlinda Musliji**



Menaxher i Projekteve

**Dardan Konjufca**

**BASHKOHU NË BISEDË**

@teachforkosova





Teach *for*  
KOSOVA

## LËVIZJE PËR ARSIM CILËSOR



Në një të ardhme, të gjithë fëmijët e Kosovës – pa marrë parasysh prejardhjen apo etninë – do të kenë qasje në një sistem arsimor që i përgatitë ata për një sukses të përjetshëm.



+383 49 170 597  
[www.teachforkosova.org](http://www.teachforkosova.org)

Prishtinë  
Rr. Rexhep Luci 30/8  
10000 Prishtinë, Kosova,